



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT

Nr. 59 prot.

Tiranë, më 19. 01. 2026

THIRRJE PËR BASHKËPUNËTORË TË JASHTËM NË KUADËR TË PROCESIT
TË PËRDITËSIMIT TË TEKSTEVE SHKOLLORE

Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM-së nr. 486, datë 17.06.2020, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollorë të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar; të VKM-së nr. 98, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”; të urdhrit të Ministrisë së Arsimit, nr. 610, datë 20.12.2024, “Për miratimin e Kornizës Kurrikulare dhe Planit të Veprimtarive për rishikimin dhe përditësimin e paketës kurrikulare të arsimit parauniversitar”; të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, nr. 26, datë 17.11.2025, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të konkurrimit, vlerësimit, përzgjedhjes dhe përditësimit të teksteve shkollorë dhe përmbajtjeve digjitale, si dhe miratimin e katalogut zyrtar të teksteve shkollorë në sistemin arsimor parauniversitar”; të urdhrit të ASCAP-it nr. 240, datë 03.12.2025, për miratimin e “Kornizës së Përditësimit të Teksteve Shkollorë”; të nenit 7 dhe neneve 10–12 të urdhrit të ministritë përgjegjëse për arsimin, nr. 32, datë 28.01.2020, “Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”; të rregullores së brendshme nr. 492 prot., datë 30.07.2020, “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) hap thirrjen për bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilët do të angazhohen në procesin e vlerësimit të përditësimit të teksteve shkollorë.

a) Detyrat e parashikuara për bashkëpunëtorët e jashtëm:

Bashkëpunëtorët e jashtëm do të angazhohen në procesin e vlerësimit të përditësimit të teksteve shkollorë duke u bazuar në dokumentet kurrikulare.

b) Kualifikimi i kërkuar për kandidatët në këtë thirrje:

1. Kandidatët duhet të kenë përfunduar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët e mësuesisë (*Arsim fillor, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë e huaj, Matematikë, Kimi, Fizikë, Biologji, Histori, Gjeografi, Art pamor, Muzikë, Teatër*) ose në fusha të lidhura ngushtë me profilin e lëndës për të cilën aplikohet.

2. Kandidatët **nuk** duhet të jenë autorë ose redaktorë të teksteve shkollore të katalogut zyrtar të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.
3. Kandidatët duhet të kenë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në arsimin parauniversitar.
4. Preferohen kandidatët me përvojë të mëparshme në procesin e redaktimit dhe vlerësimit të teksteve shkollore.

c) Realizimi i aplikimit

Dosja e aplikimit për bashkëpunëtorët e jashtëm për këtë thirrje duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- CV sipas formatit EUROPASS
- Fotokopje e kartës së identifikimit
- Diplomat dhe certifikatat
- Dëshmi të ndryshme kualifikimi

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në rrugë postare pranë ASCAP, në adresën rruga “Naim Frashëri”, nr. 37, Tiranë, Shqipëri, deri në datë **26.01.2026**.